

V E N D I M
Nr.3, datë 28.2.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar, i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani	Zv.kryetar i ""
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Manol Konomi,	Anëtar i ""
Natasha Sheshi,	Anëtar i ""
Thimjo Kondi	Anëtar i ""
Ylvi Myrtja,	Anëtar i ""
Franc Jakova,	Anëtar i ""

me sekretare Drita Filto më datat 10.2.1994, 17.2.1994 dhe 25.2.1994 shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.3 Akti që i përket:

KËRKUESE: ELSA MARA, banuese përkohësisht në Republikën e Greqisë, e përfaqësuar nga avokat Banush Selba.

PERSONI I INTERESUAR: Tonin Petaku, banues në Tiranë, lagjja 6, rruga "Ll Bonata", Pall, 13, shk,1, ap.14

O B J E K T I:

Deklarimi antikushtetues i vendimit nr.370, datë 29.4.1993, të gjykatës së apelit të Tiranës dhe vendimit nr.152, datë 11.8.1993, të këshillit gjyqësor të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.691, datë 9.3.1993, të gjykatës së rrethit të Tiranës, në çështjen civile me objekt lirim banese ndërmjet paditëses Elsa Mara dhe të paditurit Tonin Petaku, është vendosur pranimin e kërkesës.

Mbi ankimin e të paditurit, gjykata e apelit të Tiranës, me trup gjykues të përbërë prej vetëm njërit nga anëtarët e saj, me vendimin nr.370, datë 29.4.1993, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm të gjykatës së rrethit të Tiranës dhe duke e gjykuar çështjen në fakt ka rrëzuar padinë.

Ky vendim është ankimuar nga paditësja në këshillin gjyqësor të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, i cili me vendimin nr.152, datë 11.8.1993 ka vendosur mosshqyrtimin e çështjes, me arsyetimin se ankimi i paraqitur nga paditësja nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikon neni 9 i ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile".

Gjykata Kushtetuese konstaton se gjykata e apelit të Tiranës e ka shqyrtuar çështjen në shkallë të dytë jo me trup gjykues por nga një gjyqtar i vetëm më datë 29.4.1993, ndërkohë që me ligjin nr.7689, datë 17.3.1993 është përcaktuar që "Gjykatat e apelit shqyrtojnë ankimet dhe protestat kundër vendimeve penale e civile të gjykatave të shkallës së parë. Ato gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë". Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr.4 të vitit 1993, e cila ka dalë nga shtypi më 9.4.1993. Rrjedhimisht ligji ka hyrë në fuqi pas 15 ditësh, pra më 25.4.1993.

Duke shqyrtuar çështjen më datë 29.4.1993 me trup gjykues të përbërë prej vetëm një anëtar i bazë të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992, pa marrë parasysh ndryshimet që i janë bërë atij me ligjin nr.7689, datë 17.3.1993, gjykata e apelit të Tiranës i ka cënuar kërkeses të drejtën themelore kushtetuese për t'iu shqyrtuar çështja sipas një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 38 të ligjit nr.7692, datë 31.03.1993 "Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në të cilin thuhet se : "Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor".

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon, se vendimi nr.370, datë 29.4.1993 i gjykatës së

apelit të Tiranës dhe vendimi nr.152, datë 11.8.1993 i këshillit gjyqësor të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit janë akte të paligjshme që kanë cënuar rëndë të drejtat kushtetuese të kërkuases për sigurimin e një procesi të rregullt ligjor për shqyrtimin e çështjes në shkallë të dytë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në pikën 9 të nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

V E N D O S I:

Vendimi nr.370, datë 29.4.1993 i gjykatës së apelit të Tiranës dhe vendimi nr.152, datë 11.08.1993 i këshillit gjyqësor të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit janë antikushtetues.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Vendimi hyn në fuqi nga data e sotme.